



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr. 36/2022

GJYKATA SUPREME në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Zenel Leku, anëtar, në çështjen disiplinore ndaj L.Z., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë (KGJK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga gjyqtari L.Z., kundër vendimit të KGJK-së, nr.425/2022, të datës 03 Nëntor 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë, 20 janar 2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e paraqitur nga L.Z., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, KGJK. nr. 425/2022, i datës 03 Nëntor 2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë (KGJK), me vendimin KGJK.nr.425/2022, të datës 03 Nëntor 2022, në pikën I, të dispozitivit vendos; L.Z., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafin 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Në pikën II. të dispozitivit, vendos; për këtë shkelje disiplinore gjyqtarit L.Z. i shqiptohen sanksionet disiplinore, vërejtje publike me shkrim dhe zvogëlim i përkohshëm i pagës për 40%, për gjashtë, (6), muaj.

Kundër këtij vendimi gjyqtari L.Z., në afat ligjor parashtron ankesë, me të cilën e konteston në tërësi ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nr. 06/L-057, dhe Vendimit mbi sanksionin disiplinor, me propozim që: Gjykata e Supreme të merr aktvendim me të cilin të ndryshohet vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK. nr.425/2022,

të datës 03.11. 2022, dhe refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore nga Autoriteti Kompetent ,ose vendimi të prishet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim.

Me përgjigje në ankesë, KGJK ka propozuar që ankesa e paraqitur nga pala ankuese të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i atakuar KGJK nr.425/2022 i dt. 03 Nëntor 2022, të mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, përgjigjes në ankesë dhe shkresave të tjera të lëndës në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KGJK, më datë 20 prill 2022, ka pranuar kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendime se L.Z., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 5, profesionalizmi dhe përgjegjësia në punë të përcaktuar me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar. Autoriteti Kompetent bazuar në faktet e prezantuar në kërkesë, ka konsideruar se në çështjen civile C.nr.3121/20, gjyqtari nuk i kishte ndërmarrë veprimet konform përgjegjësive të tij gjyqësore, që lënda të trajtohet me efikasitet dhe të shmanget zvarritja e saj, andaj si rrjedhojë e mos veprimit të tij konstatohet se ka pasur zvarritje të procedimit të kësaj lënde, pra C.nr. 3121/20, dhe lëndëve C nr. 1576/15 dhe Cp.nr.09.2021 të kthyera në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Nga autoriteti i kompetent ekziston dyshimi i bazuar që i njëjti me mosveprimet e tij ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK-nr.156/2022, të datës 20 prill 2022, themelon Panelin Hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/10/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR/14/22. Paneli Hetimor më datën 29.06.2022 i ka paraqitur KGJK-së, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë dhe mbi faktet dhe provat e mbledhura lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara të gjyqtarit L.Z..

Këshilli më datë 15 korrik 2022, mbanë seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit hetimor të panelit, me pjesëmarrjen e kryesueses së panelit hetimor dhe avokatit të subjektit të hetimit disiplinor, Meriman Vehapi në të cilën seancë kryesuesja e panelit, deklaroi, se nuk është

kontestuese për panelin që subjekti i hetimit nuk ka ndërmarr veprime procedurale në lëndën, C nr. 3121/20, që ka pas të bëjë me kompensim dëmi në punë dhe ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit në vitin 2020 . Në lëndën C.nr.1576/15, që ka pas të bëjë me kompensim dëmi nga fatkeqësia në komunikacion , kjo lëndë është e vitit 2015, ndërsa paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja për jetën, në këtë lëndë ishin mbajtur disa seanca nga gjyqtarja S.B., por me transferimin e saj në Departamentin Ekonomik ,lënda i ishte ndarë Gjyqtarit L.Z., i cili përkundër shkresave për urgjencë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim edhe pse lënda ishte në fazën përfundimtare .Ndërsa për lëndën Cp.nr.09/2021, ankuesi ka theksuar se me datë 11.01.2021 kreditori ka dorëzuar në gjykatë propozimin për kundër përmbarrim dhe megjithëse kjo natyrë e lëndëve është urgjente edhe pas kalimit prej 1 viti e 2 muaj gjyqtari nuk ka iniciuar procedurën për lejimin ose jo të këtij përmbarrimi. Këto të gjetura për panelin hetimor nuk ishin kontestuese mirëpo paneli ka gjet se subjekti hetimor ka qen i ngarkuar edhe me një numër të madhe të lëndëve dhe me mungesë të stafit mbështetës. Përfaqësuesi si më lartë i subjektit hetimor në seancë dëgjimore ka deklaruar nuk ka asgjë të shtoj sepse raporti i panelit hetimor është i përgatitur në mënyrë profesionale.

Këshilli pas dëgjimit të deklarimeve të palëve , me qëllim që të ketë një pasqyrë reale dhe sa më të plotë të gjendjes faktike të kësaj çështje për vendosjen sa më të drejtë të kësaj çështje , në mënyrë unanime vendos që, ta kthej raportin e panelit hetimor me vazhdim mandati edhe për dy muaj, me kërkesë që të plotësohet raporti në lidhje me numrin e lëndëve me të cilat ka qen i ngarkuar subjekti i hetimit për periudhën kontestuese, çfarë natyre të lëndëve ka kryer dhe a ka kryer ndonjë lëndë që lidhet me pagat jubilarë ,marrëdhënien e punës dhe a i ka kryer lëndët sipas rregullave ligjore.

Paneli hetimor pas kryerjes së hetimit sipas kërkesës së Këshillit, me datë 19 shtator 2022, dorëzon raportin plotësues me shkrim. Me datë 22.09.2022, Këshilli mban seancë dëgjimore të radhës në panin e kryesueses së panelit hetimor dhe të autorizuarit të subjektit nën hetim, av. Meriman Vehapi. Kryesuesja paraqet gjendjen sipas të gjeturave dhe të dhënave të siguruar për periudhën 01.01.2021 deri më 30.03.2022, nga rezulton se; subjekti i hetimit ka qen i ngarkuar me 1472 lëndë, nga të cilat 513 të natyrës përmbarrimore, 958 lëndë çështje kontestimore dhe jo kontestimore dhe në mesin e tyre edhe 6 lëndë të kthyer në rigjykim. Ndërsa për periudhën kontestuese 01.01.2022 deri me datë 30.03.2022,subjekti i hetimit ka përfunduar 322 lëndë nga ky numër 296 lëndë të çështjeve përmbarrimore, prej tyre 93 janë pagesë jubilarë,182 lëndë janë borxhe ,gjobë, kompensim dëmi si dhe 26 lëndë të çështjeve kontestimore me prioritet ,si dhunë në familje, çështje familjare

,zgjdhje martese ,besimi i fëmijëve, masa të sigurimit të kërkesë padisë, ndërsa në muajin janar 2022 deri në mars 2022,ka kryer tetë 8, lëndë pagesë jubilarë ,ndërsa nuk ka kryer lëndë që nuk janë me prioritet me përjashtim kur jashtë seancës që ka nxjerrë vendim për tërheqje të padisë, për mos pagesë të taksës gjyqësore dhe kur vet pala është tërhequr nga padia. Për panelin hetimor nuk ishte kontestuese se subjekti i hetimit në periudhën kontestuese ka zgjidhur lëndë në çështje përmbarimore që lidhen me pagat jubilarë-konteste të punës, ndërsa në çështje kontestimore ka kryer lëndë të natyrës urgjente dhe jo edhe lëndë të kthyera në rigjykim. Në këtë seancë përfaqësuesi i subjektit të hetimit disiplinor deklaroi se mbetet pran deklaramëve të dhëna para panelit hetimor, dhe në seancën e kaluar dëgjimore në Këshill.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës pas përfundimit të hetimit disiplinor ,shqyrtimit të shkresave të lëndëve C. Nr. 3121/20, C nr.1576/15,dhe Cp.nr.09/2021, raporteve hetimore, dhe vlerësimit të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, nxjerrë vendimin e atakuar KGJK.nr.425/2022, të datës 03 nëntor 2022, me të cilin gjyqtari L.Z., shpallet përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i shqiptohet sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar të cituar si më lartë.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, KGJK ka theksuar se: pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit këshilli konstaton se, subjekti i hetimit disiplinor nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për të venduar tri lëndët, C. Nr. 3121/20, C nr.1576/15,dhe Cp.nr.09/2021, të cilat ishin kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit, edhe përkundër që ishin parashtruar urgjenca nga pala dhe nuk është gjetur asnjë pengesë që ka mundur të ndikoj në mos trajtimin e lëndëve kontestuese. Në këtë rast nuk ka zbatuar nenin 199 të LPK (të cilin e citon). Sipas tij parashihet që pas kthimit të lëndës në rivendosje menjëherë të caktohet seancë përgatitore apo seancë kryesore , të shqyrtimit të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit prej 30 ditë, pas arritjes së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë ,si dhe ti kryej të gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtoj të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj ,si dhe Qarkoren e evidentuar si Gj.S.459/2014 të datës 04.12.2014, të Gjykatës Supreme, për trajtimin e lëndëve të kthyera në rigjykim, që sipas saj parashihet që gjyqtari pas kthimit të lëndës në rigjykim e ka për obligimin ta caktoj menjëherë në afatin e parë kalendarik që e ka të lirë. Lëndën e njëjtë e kishte pranuar me datë 13.11.2020, fakt të cilin e ka pranuar në deklaratën e dhënë tek autoriteti kompetent por përkundër që kishte të bënte me kompensim dëmi për lëndim në punë dhe ishte kthyer në rigjykim nuk ka ndërmarr asnjë veprim procedural në drejtim të zgjidhjes së saj. Gjyqtari i çështjes ka për detyrim që në afat prej 30 ditë pas pranimit të

lëndës në rigjykim, të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për zgjidhjen e saj ,sepse lënda ka qen me prioritet e natyrës urgjente sipas ligjit dhe strategjisë së KGJK, ndërsa nga Këshilli është konstatuar se kjo lëndë pra C.nr. 3121/20,ka kaluar në periudhë kohore më shumë se një(1), vit, e katër muaj dhe i njëjti nuk ka ndërmarr asnjë veprim procedural.

Për lëndën C.nr. 1576/15, në bazë të gjeturave të këshillit ka rezultuar se, subjekti hetimor këtë lëndë e kishte pranuar prej gjyqtarës S.B. me dt. 27.04.2021 dhe nuk kishte mbajtur asnjë seancë gjyqësore edhe pse lënda ka qen në procedurë, ku ishin mbajtur pesë seanca gjyqësore nga gjyqtarja paraprake dhe konsiderohet si lëndë e vjetër. Me nenin 411 par. 1 dhe 2, të LPK përcaktohet ,”seanca për shqyrtim kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet në kohë të pa caktuar, seanca dëgjimore kryesore nuk mund të shtyhet me shumë se 30 ditë, për veç rasteve të përcaktuara me ligj”, ndërsa në par. 4, të njëjtit nen parashihet se, ”në qoftë se shtyhet seanca ,gjyqtari ka për detyrë që ti merr të gjitha masat e mundshme me qëllim që të hiqen shkaqet që kanë shkaktuar shtyrjen ,si dhe me qëllim që në seancën e ardhshme të përfundoj normalisht shqyrtimi i çështjes”.

Ndërsa sa i përket lëndës Cp.nr. 09/21,Këshilli konstaton se gjyqtari nga data e pranimit të kësaj lënde 01.03.2021 nuk kishte ndërmarr asnjë veprim në drejtim të zgjidhjes së saj deri me dt.25.03.2022 ,kur merr konkluzion me të cilin urdhërohet kreditori i kundër përmbarimit të paguaj taksën gjyqësore dhe dorëzimin origjinal apo kopje të noterizuar të aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Edhe në rastin konkret konstaton se lëndët kundër përmbarimit janë të natyrës urgjente sipas Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore , ku është dashtë të veprohet në afat prej shtatë ditësh.

Këshilli tutje arsyeton se gjatë kësaj periudha subjekti i hetimit përkundër që e ka pas për obligim ligjor për trajtimin e lëndëve të cekura si më lartë, i njëjti ka kryer lëndë tjera që nuk kanë qen me prioritet ligjor. Nga të gjeturat Këshillit të konfirmuara edhe nga kryesuesja e panelit hetimor subjekti i hetimit disiplinor gjatë periudhës kontestuese nuk ka mbajtur asnjë seancë për çështje kontestimore dhe nuk ka marrë asnjë vendim meritor ,për veç disa lëndëve me natyrës, dhunë në familje.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar KGJK, ju ka referuar nenit 7 paragrafi 1, pika 1.2,1.3, dhe paragrafi 2, pika 2.1, 2.2, dhe 2.5, të Ligjit nr. 06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, nga rezulton që vendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, dhe vendimi mbi sanksionin e shqiptuar disiplinor është në masë proporcionale në raport me shkeljen e kryer nga gjyqtari.

Pala ankuese në ankesën e paraqitur si bazë i është referuar zbatim të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore, megjithatë nuk ka cekur dispozita konkrete të këtij ligji prandaj sa i përket kësaj baze gjykata supreme i referohet dhe kufizohet vetë në shkelje të cilat ekzaminohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me çrast gjen se vendimi i ankimuar i KGJK nuk është i përfshirë me shkelje të këtij ligji, Apo Kodit të Etikës lidhur me procedurën e zhvilluar disiplinore përgjegjësinë dhe sanksionin disiplinor shqiptuar gjyqtarit në fjalë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i vendimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. KGJK, ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, KGJK, në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rezultuar vërtetimi i përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, dhe shqiptimin e sanksioneve disiplinore si në vendimin e KGJK.

Pretendimet ankimore lidhur gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ashtu si thekson ndër të tjera se; KGJK, nuk i ka vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku dhe gjatë vendimmarrjes nuk ka dhënë arsyetim lidhur me pretendimet e paraqitura, se ka qenë i ngarkuar vetëm me lëndë përmbartimore dhe prej muajit tetor 2020 është ngarkuar edhe me lëndë kontestimore, se nuk është kontestuese se ka punuar vetëm me lëndë me prioritet dhe ka përmbushur normën, si dhe cekja e disa rrethana të tjera që kanë qenë pengesë për efikasitet në punë në këtë periudhë kohore si, prindi i sëmurë rëndë, mendjes se ka qenë gjyqtar fillestar, vit pandemie, se nuk ka pas mbështetje administrative, etj., sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme nuk janë të qëndrueshme dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje dhe për tu liruar nga përgjegjësia dhe shqiptimi i masave disiplinore, sepse në bazë të provave të mbledhura nga paneli hetimor sipas raportit dhe plotësim raportit të bërë sipas udhëzimeve të KGJK, deklaratës së

subjekti nën hetim të dhënë para panelit hetimor të administruara në seancë dëgjimore nga KGJK në praninë e kryesueses së panelit dhe përfaqësuesit të subjektit në hetim, janë shqyrtar të gjitha rrethanat megjithatë në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se gjyqtari L.Z., është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme në kryerjen e detyrave zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj, për të vendosur tri lëndët e cekura si në vendimin e ankimuar të KGJK. lëndët C.nr.3121/20,C. Nr.1576/15 dhe Cp.nr.09/2021, edhe përkundër që palët kishin ushtruar urgjenca për tu vepruar sipas ligjit, dhe po ashtu i njëjti në periudhën kontestuese prej 01.01.2021 e deri 30.03.2022, nuk ka mbajtur asnjë seancë për çështje kontestimore dhe nuk ka marrë asnjë vendim meritator përveç disa lëndëve të natyrës dhunë në familje.

Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar qëndrimin e KGJK-së për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “*Shkelja e detyrave të gjyqtarit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj*”. Me nenin 7 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “*Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët; 1.5. propozim për shkarkim*”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Masat disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore*”.

Me nenin 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, përcaktohet se: “*Gjyqtari mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale të përgjegjshme dhe efikase*”, me paragrafin 1 të këtij neni, përcaktohet se: “*Funksioni i gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit*”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se:

“Gjyqtari është i detyruar që të organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës”, ndërsa me paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se: “Gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshme”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe dispozitave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KGJK drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i’ a ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KGJK është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marr parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga gjyqtari, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore, siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2.7, dhe sanksionit disiplinor të shqiptuar si në kuptim të nenit 7, par.1 pika 1.2 dhe 1.3, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sanksioni disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor dhe vlerësohet se do të ketë efekt pozitiv ashtu që i njëjti në të ardhmen të veproj konform Ligjit, rregullave të Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për Gjyqtarë. Prandaj, parashtrimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara.

Nga arsyet e paraqitura, bazuar në nenin 15.6, të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME-PRISHTINË

A.A.nr.36/2022, me datë 20.01.2023

Kryetari i kolegjit

Ragip Namani